Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 396/01
Datë 06.11.2015

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 mbi Kualifikimet Kombëtare të datës 7 nëntor 2008 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 35/2014 të datës 20. 11. 2014 mbi Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me nenet 4, 7, 10, 11, 16 dhe 17, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve me datë 06.11.2015 nxjerr këtë:

V E N D I M

1.1. Për ri- akreditimin e Britannica ELT edhe me një degë në Prishtinë, për periudhën: 06.11.2015 deri 06.11.2018 për të ofruar:

1.1. Gjuhë angleze

Riakreditimi i institucioni/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim:

Kushtet:

- Procedurat mbi evakuimin nga zjarri, nxënësve dhe stafit në të gjitha qendrat duhet t'u bëhet e ditur procedura mbi evakuimin në rast të zjarrit.
- Pyetësori mbi vlerësimin e menaxhmentit duhet të jetë anonim.
- Formulari i vlerësimit nga ana e nxënësve të përkthehet në gjuhën shqipe.
- Vrojtimet në klasë të jenë më të strukturuara.
- Të përmirësohet formulari i vrojtimit të kolegëve.
- Mbajtja e trajnimeve rreth dhënies së 'feedback-ut'.
- Vendosja e kutive të ankesave në të dy objektet.

(Afati kohor: 31.01. 2016)

2. Arsyetim

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit me datë: 02.03.2015, Këshilli Drejtues i AKK-së merr këtë vendim bazuar në rekomandimet të dala nga Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Validimin e kualifikimit, Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Akreditimin e Institucionit i cili ofron dhe/ose vlerëson dhe lëshon kualifikime të aprovuara dhe këto rekomandime janë të mbështetura në fakte dhe dokumente si në vijim:

- Aplikacioni për Akreditim si Institucionit Ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit;
- Raporti i Vetë-vlerësimit;
- Vizita në institucionin/ofruesin aplikues, dhe
- Dokumente tjera shtesë.

2.1. Pala e pakënaqur me vendimin, ka drejtë ankese në organet e shkallës së dytë. Ankesa bëhet përmes organit të shkallës së parë.

3. Kushtet e parashtruara për aprovim dhe akreditim duhet të përmbushen në afatin e caktuar nga AKK, në rastin kur institucioni/ofruesi nuk i përmbushë këto kritere, AKK ka të drejtë tërheqjen e aprovimin dhe akreditimit.

4. Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit të tij.

5. Vendimi i dërgohet:
   - Britannica ELT në Prishtinë; dhe
   - AKK.

Nën- Kryetari i KD së AKK-së
Anton Gojani